

# buletini info

Buletin informativ mujor  
Maj, 2022




## 20 KOMUNA PËRFITOJNË RRETH 1 MILION EURO PËR PROJEKTE INFRASTRUKTURE PËR KOMUNITETE



Valmir Rama, Nënkyetar  
për komunitete në Istog



Nga e kanë prejardhjen  
jevgit?



Gjenerata e viteve  
1963/68 e shkollës  
normale në Pejë

## Rasti i segregacionit të nxënësve në Pejë është i rendë por nuk është dukuri

**S**hkolla ka qenë gjithmonë vendtakimi i jonë me bashkëmoshataret tanë që na ka dhënë rast të krijojmë shoqëri, miqësi.

Rasti i Pejës, i manifestuar me segregacion etnik të nxënësve, në një ambient ku po festonte klasa e parë, ishte një rast i rendë për Pejë, Rrafshin e Dukagjinit dhe për Kosovën. Është evidente se racizmi ekziston dhe manifestohet çdo ditë në kurriz të komuniteteve të marginalizuara, por në shkolla kjo nuk duhet të ndodh, sepse aty fëmijët e formësojnë vetëdijen për relacionin me rrethin shoqëror. Rasti i segregacionit të nxënësve në Pejë është i rendë por nuk është dukuri që ndodh gjithmonë dhe çdo kund. Unë jam dëshmitar kur nxënës të komunitetit Egjiptian e kanë udhëhequr festën e abetares. Pra është mirë kur mësues dhe udhëheqës të shkollave e vlerësojnë talentin e nxënësve pa ngarkesa racore apo etnike.

Dukuria e bullizimit të nxënësve të komuniteteve jo shumicë nga moshatarët e tyre është evidente. Institucionet arsimore në Kosovë duhet të jenë të alarmuar dhe të hartohen masa konkrete për të mposhtur këtë dukuri të vrazhdë e cila përcillet me pasoja në të ardhmen e nxënësve.

Valmir Rama është emëruar Nënkyetar për komunitete në komunën e Istogut. Pozita e përfaqësimit të lartë politik në Istog rikthehet pas tetë viteve. Ky përfaqësim, në katër vitet e ardhshme, është një mundësi e kompensimit të përfaqësimit politik në Kuvendin Komunal i cili nuk është arrit më votat tona. Emërimi i Nënkyetarit për komunitete në komunën e Istogut është rezultat i Marrëveshjes që kishte arritur IRDK me kandidatin e LDK-së në komunën e Istogut, në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës. Marrëveshja ishte realizuar në frymën e besimit të krijuar me vite në mes të IRDK-së dhe LDK-së, që e mbanë pushteti komunal që nga pas lufta. Në këtë rast, patëm një numër të anëtarëve të Kryesisë së degës së IRDK-së të cilët nuk e respektuan vendimin e Kryesisë për këtë marrëveshje. Ne u pajtuam që të respektojmë orientimet edhe të atyre që nuk përfillen vendimin e Kryesisë në

mënyrë që t'i evitojmë përplasjet brenda komunitetit.

Edhe udhëheqësit e partive tona politike e dinë se përfaqësimi komunal arrihet duke u bashkuar dhe duke i lenë pas dallimet politike. Interesat partiake nuk duhet t'i dëmtojnë interesat e komunitetit sikurse po na ndodh që tetë vite. Prandaj është koha që të mos dëgjohen ata udhëheqës që dalin kundër unitetit të komunitetit, sepse këtë e bëjnë vetëm për interesin e tyre personal.

Mbi 1 milion euro do të investohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për projekte të komuniteteve të cilat do të realizohen nga komunat. Mbi 20% duhet të participoj secila komunë që është përfituese e këtij fondi. Nga marrëveshjet e bashkëpunimit që janë nënshkruar në mes të Ministrit Elbert Krasniqi dhe Përfaqësuesit e komunave kemi kuptuar që përfitues të këtij fondi do të jenë edhe komuniteti Egjiptian dhe Ashkali në dhjetë nga njëzetë komuna që janë përfituese të fondit. Projektet infrastrukturore do të realizohen për komunitetin Egjiptian dhe Ashkali në këto komuna: Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Klinë, Lipjan, Deçan, Istog, Obiliq dhe Rahovec. Ky është një standard i ri që po vendoset mbi shpërndarjen e barabartë të fondeve për financimin e projekteve. Në Qeveritë e kaluara, asnjëherë komuniteti Egjiptian e Ashkali nuk ka qenë përfitues i projekteve nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Është konstatim i saktë se fondet me të cilat do të financohen këto projekte janë nga taksat e qytetarëve të Kosovës dhe rrjedhimisht edhe taksat tona por taksat tona për shumë vite nuk janë kthyer tek ne, aty ku ka nevojë më së shumti për investime. Prandaj vëmendja nga niveli qendror e treguar për komunitete është një standard që duhet vazhduar për çdo vit. Veprimet konkrete të Qeverisë, sikurse tani përmes financimit të projekteve infrastrukturore, i jep kuptim edhe përfaqësimit politik të komuniteteve jo shumicë përmes vendeve të garantuara.

**Fazli Stollaj**






## **VALMIR RAMA, NGA IRDK, EMËROHET NËNKRYETAR PËR KOMUNITETE NË KOMUNËN E ISTOGUT**

Valmir Rama, bartës i listës së IRDK-së në Istog në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në tetor të vitit 2021, do të ushtroj funksionin e Nënkyetarit të Komunës së Istogut nga radhët e komuniteteve. Kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, me datën 29.04.2022 i ka propozuar Kuvendit Komunal vendimin për nominimin e Valmir Rama për Nënkyetar për komunitete në komunën e Istogut. Anëtarët e Kuvendit e kanë miratuar propozimin e kryetarit të komunës dhe Valmir Rama pitet të filloj të ushtroj këtë funksion nga fillimi i qershorit, pasi të jetë bërë konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Kjo është bërë e ditur me datën 23.04.2022, në një takim në mes të Kryetarit Ilir Ferati dhe Nënkyetarit Valmir Rama.

Valmir Rama është zgjedhur Nënkyetar për Komunitete në komunën e Istogut pas bashkëpunimit në mes degës së IRDK-së dhe LDK-së në zgjedhjet e fundit lokale për kryetar komune. IRDK, e përfaqësuar nga deputeti Fridon Lala dhe kandidati i LDK-së për kryetar komune, Ilir Ferati, me datën 07.11.2021 nënshkruan marrëveshje lidhur me zgjedhjet e balotazhit për kryetar komune dhe u pajtuan që pozita e Nënkyetarit për komunitete në komunën e Istogut të propozohet nga ana e IRDK-së. Marrëveshja përfshinë edhe balancimin e numrit të punësuarve në administratën komunale, ndërmarrje komunale, në institucione arsimore dhe shëndetësore me të punësuar të ri nga radhët e komunitetit Egjiptian duke i dhënë përparësi grave dhe vajzave të kualifikuara. Gjithashtu marrëveshja specifikon masat për parandalimin e braktisjes së shkollimit parafillor dhe fillor dhe rritjen e nxënësve në shkolla të mesme nga radhët e komuniteti egjiptian, realizimin e projekteve të infrastrukturës në vendbanimet e komunitetit Egjiptian dhe projekte për punësim dhe gjenerim të të ardhurave si dhe realizimin e projekteve të banimit për të pa strehët dhe për familjet të cilat banojnë në kushte të renda.



Me qëllim të bashkëpunimit në zgjedhjet e balotazhit për Kryetar të Komunës së Istogut, Kandidati për Kryetar Komune nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës - LDK dhe Dega e Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK në Istog pajtohen për këtë

## MARRËVESHJE

- I. IRDK dega në Istog për zgjedhjet e balotazhit për Kryetar të Komunës së Istogut që do të mbahen me datën 14 Nëntor 2021, e mbështetë kandidatin e LDK-së z. Ilir Ferati.
- II. IRDK fton të gjithë anëtarët e saj në Istog që me datën 14 Nëntor 2021 të dalin në vendvotime dhe të votojnë z. Ilir Ferati për Kryetar të komunës së Istogut.
- III. Kandidati për Kryetar të komunës së Istogut, z. Ilir Ferati, zotohet që pas marrjes së detyrës së Kryetarit të Komunës, menjëherë pas emërimit të Drejtorëve të Drejtorive Komunale, në përputhje me praktikën në komunat tjera dhe në koordinim me asamblëistin nga radhët e komunitetit boshnjak, i paraqet Kuvendit Komunal për miratim vendimin për emërimin e Nënkryetarit për Komunitete, të propozuar nga IRDK.
- IV. Kandidati për Kryetar të komunës së Istogut, z. Ilir Ferati, zotohet se, pasi të marrë detyrën e Kryetarit të Komunës së Istogut, do të:
  - balancohet numri i të punësuarve në administratën komunale, ndërmarrjet komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore me të punësuar të ri nga radhët e komunitetit Egjiptian duke i dhënë përparësi grave dhe vajzave të kualifikuara.
  - merrë masa për parandalimin e braktisjes së shkollimit parafillor dhe fillor dhe rritjen e nxënësve në shkollat të mesme nga radhët e komunitetit egjiptian.
  - realizon projekte të infrastrukturës në vendbanimet e komunitetit Egjiptian dhe projekte për punësim dhe gjenerim të të ardhurave.
  - realizon projekte të banimit për të pa strehët dhe për familjet të cilat banojnë në kushte të renda.



## **ZGJEDHEN STRUKTURAT E REJA NË DEGËN E IRDK-SË NË ISTOG**

**Lush Çukaj do ta drejtoj degën e IRDK-së  
në katër vitet e ardhshme**

Kuvendi i VIII-të zgjedhor i IRDK-së, dega në Istog, ka mbajtur mbledhje në të cilën janë zgjedhur strukturat drejtuese të kësaj dege në komunën e Istogut. Kryetari i deritanishëm i degës së IRDK-së në Istog, Abedin Neziraj ka përmendur zhvillimet kryesore në katër vitet e fundit sa e ka drejtuar këtë degë. Ai ka përmendur zvogëlimin e dallimeve politike, fitoren në dy palë zgjedhje parlamentare të mbajtura në vitin 2019 dhe 2021 dhe pakënaqësinë me rezultatin e zgjedhjeve lokale që u mbajtën në fund të vitit të kaluar. Ai falënderoj shumë të gjithë bashkëpunëtorët e Kryesisë së degës që punuan gjatë kësaj periudhe dhe kryetarin e IRDK-së për mirëkuptimin që ka treguar. Përmes votimit të fshehtë, kryetar i degës së IRDK-së në Istog është zgjedhur Lush Çukaj, i cili deri më tani ka ushtruar pozitën e nënkryetarit të degës. Nënkyetar i parë është zgjedhur Valmir Rama, Nënkyetar i dytë është rizgjedhur Smajl Zikolli dhe Sekretare Organizative është zgjedhur Valbona Hajrizaj.

Kuvendi i VIII-të zgjedhor gjithashtu ka zgjedhur 15 anëtarë të Kryesisë dhe 15 delegatë të cilët do të përfaqësojnë degën e Istogut në Kuvendin e Përgjithshëm Zgjedhor.

Në punimet e Kuvendit ka marrë pjesë edhe deputeti Fridon Lala dhe Zyrtari Financiar i IRDK-së Skender Qorri.





Pas zgjedhjes në pozitën e Kryetarit të degës së IRDK-së në Istog, Lush Çukaj ka shkruar: *“Sot e kam marrë besimin e anëtarëve të Kuvendit të degës së IRDK-së që të drejtoj këtë degë. I falënderoj anëtarët e Kuvendit që më besuan pozitën e Kryetarit të degës së IRDK-së në Istog. Në këtë detyrë, bashkë me Kryesinë, do të punojmë për unifikim, përparim dhe për të mirën e të gjithë qytetarëve të komunës së Istogut”*.

Me datën 25.05.2022, kryetari i degës së IRDK-së në Istog, bashkë me Nënkryetarët Valmir Rama dhe Smajl Zikolli, janë takuar me kryetarin e IRDK-së Elbert Krasniqi në ç’rast kanë marrë urime dhe përkrahjen për pozitat në drejtimin e degës së IRDK-së në Istog.



## **MINISTRI ELBERT KRASNIQ INSPEKTON REALIZIMIN E PROJEKTEVE NË KOMUNËN E ISTOGUT**

Ministri Elbert Krasniqi, me datën 25.05.2022, ka qënë për vizitë zyrtare në komunën e Istogut. Në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Istogut, ministri Krasniqi është pritur nga Kryetari i komunës Ilir Ferati dhe Nënkryetari i Komunës nga radhët e komuniteteve Valmir Rama. Në takim është diskutuar për projektet e bashkëfinancuara, për realizimin e tyre dhe për projektet të cilat do të financohen në të ardhmen.

Ministri Elbert Krasniqi, i shoqëruar nga nënkryetari për komunitete i Komunës së Istogut Valmir Rama, kanë vizituar lokacionet ku janë realizuar disa nga projektet e bashkëfinancuara nga MAPL. Në këtë rast, është vizituar Rruga “Perëndimi” në Gurrakoc, Rruga “Alush Aga” në Zallq dhe Rrugën “Livadhet e thata” në Shalinovicë. Projekti për asfaltimin e rrugës “Alush Aga” në Zallq nuk është përfunduar dhe ministri Krasniqi ka marrë zotimin e autoriteteve të komunës së Istogut që ky projekt do të kompletohet gjatë këtij viti.





*Rruga "Perendimi" në Gurrakoc të komunës së Istogut, është njeri prej projekteve të bashkëfinancuar nga MAPL.*



*Rruga "Livadhet e Thata" në Shalinovicë, komuna e Istogut, është projekt i bashkëfinancuar nga MAPL.*



## GJENERATA E VITEVE 1963/68 E SHKOLLËS NORMALE ALI KELMENDI TË PEJËS



**Artan Ferizaj**

Tri paralelet: Paralelja e Pejës, Deçanit dhe e Istogut.

Këta normalistë, pasi që përfunduan normalen disa filluan punën si mësues, të tjerët vazhduan studimet.

Tani më kanë kaluar 54 vite nga gjenerata e vitit 1968-të të shkollës normale të Pejës.

Rruga e sakrificës, nderit dhe diturisë nga Klina vazhdon në Pejë e Haxhi Zekës.

Babai në moshë 9 vjeçare mbeti jetim dhe barra mbi krye i bie vllaut më të madh se babai.

Populli ishte i lodhur nga varfëria që e kishte kapluar në atë kohë.

Në njërën anë pasojat e luftës së dytë botërore dhe në tjetrën anë shtypja nga pushtuesi.

Vitet e shkollës normale ishin shumë të mundimshme, sepse duhej të sigurohet, ushqimi, banimi me qera dhe veshmbathja aty këtu.

Ishte koha migjeniane, e donte atë qytezë, ato rrugë të mbushura me varfëri. Shpirti i ngjallej nga mundi, donte të kthehej aty pranë shtëpisë.

Dhembshuria për vendin e lindjes e bënte për vete shpirtin e tij.

Në lenden e arsimit muzikor, disa nxënës e përsëriten provimin pranues.

Eh sa vlerë kishin notat e mira që merrnin fëmijët në shkollë, sa vlerë kishte performanca e tyre e shkëlqyer në mësim, kur nuk kishin as mjete për të mësuar, dhe ato mjete që i posedonin, i ndanin se bashku.

Leximi i veprave të anatemuara të asaj kohe mbillte dashuri për leximin, mbi të gjitha, përpjekje për të vizualizuar botën, si veprat e At Gjergj Fishtës, Faik Konices, Mitrush Kutelit, Lasgush Poradecit etj.

Atë kohë kishte më shumë ndjenja, e më pakë egoizëm dhe varfërim/mjerim emocional.

Fëmijët, para së gjithash, janë mësuar të bëhen njerëz me vlera, pra edukimi ishte vetë JETA.

Oborrit të kësaj shkolle bukuri edhe më shumë i jepnin tingujt e kitarës së Isuf Gervallës.

Një vit më parë normalen e kreu edhe Ibrahim Rugova.

Më kujtohen shumë mirë edhe demonstratat e vitit 68- të, ne ishim në krye të atyre demonstratave në qytetin e Pejës.

Jam mësuar që sfidave dhe sprovave të jetës të iu dalë përballë dhe besoja që një ditë do të vijojnë ditë më të mira.

Kjo rini ishte themel i shtetit të ardhshëm të quajtur Republika e Kosovës.

Profesorët e shkollës Normales Ali Kelmendi të Pejës të gjeneratës 63/68 ishin:

Shemsedin Hadri, Jahja Nila, Rexhë Gjonbalaj, Zyhdi Çakolli, Sadri Kelmendi, Hajrullah Gruda, Ramë Berisha, Rexhep Podrimaj, Metë Hamza, Riza Brada etj.

Prej 151 nxënësve gjithsej nga komuna e Klinës ishin: Uke Bashota, Mark Prenaj, Musli Ferizaj, Sahit Sahiti, Gjon Saliquuni, Zenun Atashi, Qamil Rama etj.

Në vitin 1968 ka filluar punën shkolla e mesme "Luigj Gurakuqi" në Klinë.

Pra këto ishin disa copëza kujtimi nga babai im.

## PROJEKTE INFRASTRUKTURE PËR KOMUNITETE



**LIPJAN**



**Asfaltimi i rrugëve në Lipjan dhe Hallaq i Vogël**

**40 000 €**



**RAHOVEC**



**Ndërtimi i rrugëve dhe këndit rekreativ në lagjen e komuniteteve**

**40 000 €**



**OBILIQ**



**Punimi i kanalizimit dhe Asfaltimi i rrugës në Plementim**

**40 000 €**



## PROJEKTE INFRASTRUKTURE PËR KOMUNITETE



ISTOG



**Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët: 7 Marsi në Gurrakoc, 24 Qershori në Zallq, Verrini në Kovragë dhe Asfaltimi i rrugës Sadri Lata në Zallq**

**50 000 €**



PEJË



**Muri rrethues në shkollën fillore "Asdreni" dhe "Xhemajl Kada"**

**40 000 €**



KLINË



**Ndërtimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatin Dresnik dhe Shtupel**

**40 000 €**

## PROJEKTE INFRASTRUKTURE PËR KOMUNITETE



### GJAKOVË



Kubëzimi i rrugëve: "Brahim Zeka" në Skivjan, "Fadil Tolaj" në Piskotë, "Alipashe Tepelena"- mahalla e Sefes, "Martiret Dinaj" - mahalla Lekaj dhe "Hysen Mehmeti"

**70 000 €**



### FERIZAJ



Asfaltimi i rrugës dhe trotuarit në fshatin Dubravë

**40 000 €**



### MITROVICË



Termoizolimi dhe zëvendësimi i dritareve në shkollën fillore "Shemsi Ahmeti"

**40 000 €**





## NGA E KANË PREJARDHJEN JEVGJIT?

Te flasësh për jevgjiti në një kohë kur mungojnë literaturat dhe studimet shkencore është e vështirë. Nëse nisemi nga tiparet e një jevgjiti "puro", vihen re tipare mesdhetare në tonalitete pak të errëta të lëkurës, siç e përshkruan Herodoti: "Një egjiptian është i ngjashëm me një grek të cilit i është pigmentuar lëkura nga dielli". Përhapja e egjiptianëve në Mesdhe është e faktuar nga shkrimet e antikitetit. Ashtu siç është e faktuar edhe prezenca e persianeve. Po të futim këtu edhe lëvizjet migratore të popujve Indoeuropiane, të ndodhura në Ballkan problemi i etnogjenezës bëhet edhe më i vështirë. Të kthehemi në kohët e sotme... . Pak a shume në Shqipëri termi "jevg" përdoret si denigrues për të përshkruar mungesën e higjienës, mungesën e arsimit dhe me shume here për të përshkruar një njeri me lëkurë të pigmentuar lehtë. Në këtë grupim të quajtur "jevg" bile futen të gjithë personat me lëkurë të pigmentuar lehtë, duke bërë barazimin jevg=njeri me ngjyrë. Po të hedhesh një sy në librat e historisë, vihet re se njerëzit me ngjyrë në Ballkan kanë disa origjina të njohura në mase:

1. Egjiptianet e vjetër
2. Perset
3. Dyndjet barbare të mesjetës (Hunet, Bullgaret, Avaret)
4. Turqit
5. Indianet (Romet)

Në ditët tona në Shqipëri ka dy popullsi me lëkurë të pigmentuar, të cilat kanë karakteristika dhe tipare antropologjike të ndryshme nga njëra tjetra;

1. Ajo qe ne e quajmë "Jevgj", "Evgjitë", "Magjupe", "Ashkalinj", "Tabake", e cila ka tipare mesdhetare (lëkurë e pigmentuar lehte, ose jo), europoide, duke përberë një grupim të veçantë kulturor. Kjo popullsi është integruar me popullin shqiptar (në të gjitha aspektet e integritimit kulturor dhe etnologjik)

2. Dhe një popullsi tjetër të cilën ne e quajmë "Gabele", "Kurbeter", "Rome", "Harixhinj", me tipare të theksuara Indo-Mongole. Është një grupim etnik i diferencuar dukshëm nga pjesa tjetër e popullsisë nga gjuha dhe mënyra e jetesës. Nuk është integruar ende me popullin shqiptar dhe ndajnë kulture dhe hapësirë të ndryshme.

Deri në këtë pikë, problemi behet me i thjeshte, pasi nga 5 grupime origjine, arrihet në 2 përfundime. Nga njëra anë "Jevgjiti", të cilët formojnë një konglomerat qe ka përfshirë të gjithë pjesëtarët me lëkurë të hiperpigmentuar, pavarësisht etnogjenezës, si dhe Romet, të cilët ende pas shekujsh ruajnë gjuhen, dhe kulturën e tyre.

Nëse problemi i përcaktimit të origjinës së Romeve është i përcaktuar tashme nga studimet shkencore, ku ka rezultuar si vend origjine Provinca e Rajastanit (Indi), nisur nga ngjasimet gjuhësore, ato të ADN si dhe ato historike (emigrimi i banoreve të Rajastanit pas pushtimeve të Mahmud Ghazni, një pushtues nga Kalifati arab), problemi i përcaktimit të origjinës së "jev gjiteve" është i vështirë për të mos thënë i pamundur. Sepse nën këtë grupim janë përfshirë të gjithë njerëzit me lëkurë të hiperpigmentuar të ardhur nga Egjipti i lashtësisë, nga Perset e lashtësisë, nga dyndjet barbare të mesjetës si dhe se fundmi nga turqit.

Pra kur flitet për "jev gjit" nuk behet fjale për "popull/komb", por për tipare! Për këtë arsye çdo përpjekje për ti quajtur "jev gjit" egjiptiane është e pafaktuar dhe jo e sakte! Siç dihet raca dhe marrëdhëniet sociale nuk shkojnë në të njëjtin drejtim. Njerëzit ashtu siç bëjnë tregti me njeri tjetrin, shkojnë në lufte përkrah njeri tjetrit, punojnë tokën përkrah njeri tjetrit ashtu edhe lidhen në martesë me njeri tjetrin, e në fund të fundit "raca dhe seksi janë në përpjesëtim të zhdrejte".

Nëse në rastin e Romeve vihet re një popullsi totalisht e ndarë nga pjesa tjetër e popullsisë, në rastin e "jev gjiteve" bashkëpunimi, lidhjet sociale dhe territori i njëjtë është i dukshëm! Çështja Rome është ndër kombëtare, ndërsa çështja Jevge është çështje kombëtare shqiptare. "Jevgjiti" brenda komunitetit të tyre kanë ndarje të shumta sociale, të cilat vijnë si rezultat edhe i origjinës së tyre, pozitës financiare dhe administrative që kanë pasur në shekuj. Për shembull një jevg pasardhës i të cilit kanë origjinë nga egjiptianët e lashtë, tashme është krejtësisht i asimiluar në tipare me popullatën vendase, e njëjta gjë mund të ndodhi edhe me një jevg paraardhës i të cilit ishin turq apo persiane. Dihet se popullata shqiptare dhe ajo turke kanë patur lidhje martesore gjatë pushtimit, si shembull përmendim se gruaja e Sulltan Mehmetit ishte shqiptare, dhe nga ana tjetër gruaja e Iljaz Bej Mirahorit (themeluesit të Korçës) ishte turke, e njëjta gjë ka ndodhur dendur, dhe jo vetëm në Shqipëri, duke bërë që të vijnë në jetë pasardhës me tipare të mesme e deri të padallueshme nga popullsia vendase. Ajo që mund të thuhet është se "Jevgjiti" janë grup etno-kulturor dhe asesi grup racor. Një "jev gjit" mund të jete i bardhe, mund të jete flokëkuq, mund të jete biond me sy bojeqielli etj, ashtu sikundër ndodh shpesh që edhe një jo-jevg, mund të jete me lëkurë të pigmentuar lehtë. Romet historikisht kanë patur si profesione të tyre, muzikën, argëtimin, cirkun, dhe disa zeje si thurja e thuprave.

Jevgjiti historikisht kanë patur si profesione të tyre, përpunimin e hekurit, bujqësinë, shërbimin ushtarak, duke vazhduar me tej edhe me zejet dhe mjeshtëritë e tilla si qëndisja, qilimat, sixhadet etj.

Në kohët moderne, Romet vazhdojnë ende të mbeten të pa integruar, gjë e cila nuk mund të thuhet për "jev gjitet", të cilët janë arsimuar, kanë fituar pozitë financiare dhe sociale duke filluar që prej kohës së Zogut I.

Gjatë komunizmit, nëse Romeve u jepej si pune thurja e thuprave etj., "jev gjiteve" zakonisht u është dhënë punë njëloj si klasës së mesme në Shqipëri, ka pasur mjaft raste të avancimit në karriere si dhe të marrjes së pozitave drejtuese ekonomike dhe politike.



# *buletini* info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: [buletini.info@gmail.com](mailto:buletini.info@gmail.com)